R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.2190/1 prot. Tiranë, më 14.8.2026

Lënda: Mendim mbi projektligjin "*Për shërbimet digjitale në Republikën e Shqipërisë*"

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj nr. 6391 prot., datë 29.07.2026, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin "*Për shërbimet digjitale në Republikën e Shqipërisë*", së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Fillimisht, sqarojmë se Zyra e Komisionerit ka shqyrtuar projektligjin në funksion të fushave të veprimtarisë që janë në kompetencën e institucionit, me synim përputhshmërinë e zbatimit të legjislacioneve respektive, shmangien e paqartësive si dhe garantimin e ushtrimit efektiv të të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu, dispozitat për të cilat kemi dhënë sugjerime janë parë edhe në raport me transpozimin e projektligjit me Rregulloren (EU) 2022/2065 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 19 tetori 2022 "*Për një treg të vetëm për shërbimet digjitale dhe ndryshimin e Direktivës 2000/31/EC*", *(Akti për Shërbimet Digjitale – në vijim "DSA").*

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit rezulton se kryesisht disa prej dispozitave të tij rregullojnë veprimtari që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht në lidhje me reklamimin online, profilizimin, mbrojtjen e të miturve dhe aksesin në të dhëna të platformave online.

Kështu sa i përket, dispozitave që lidhen me respektimin e parimeve dhe kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 124/2024 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" Zyra e Komisionerit, sugjeron si më poshtë vijon:

Në pikën 3, të nenit 26 të projektligjit parashikohet se "*3.Ofruesit e platformave online nuk u paraqesin marrësve të shërbimit reklama të bazuara në profilizim, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 124/2024 për mbrojtjen e të dhënave personale*".

Kjo pikë parashikon ndalimin e paraqitjes së reklamave të bazuara në profilizim, duke iu referuar në mënyrë të përgjithshme ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Në këtë drejtim, vlerësohet e nevojshme të qartësohet shtrirja e këtij ndalimi, duke përcaktuar në mënyrë më të saktë profilizimin sipas kategorive të të dhënave personale që nuk mund të përdoren për paraqitjen e reklamave, në këtë mënyrë dispozita të jetë në përputhje edhe me qëllimin dhe përmbajtjen e nenit 26 të DSA-së (*dhe jo më e gjerë se ajo*), duke shmangur interpretimin se ndalohet në mënyrë absolute çdo formë e reklamimit bazuar në profilizim.

Kësisoj, po ti referohemi pikës që transpozon neni, konkretisht pikës 3 të nenit 26 të DSA, parashikohet se "*Ofruesit e platformave online nuk duhet t'u paraqesin reklama marrësve të shërbimit bazuar në profilizimin siç përcaktohet në nenin 4, pika (4), të Rregullores (BE) 2016/679 duke përdorur kategori të veçanta të të dhënave personale të përmendura në nenin 9, paragraphe 1, të Rregullores (BE) 2016/679*."

Në këtë kuadër, sugjerojmë që ***pika 3, e nenit 26 të projektligjit*** të ndryshohet më këtë përmbajtje: "3. *Ofruesit e platformave online nuk u paraqesin marrësve të shërbimit reklama të bazuara në profilizim, duke përdorur kategori të veçanta të të dhënave personale, të përcaktuara në pikën 28 të nenit 5 dhe nenit 9 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"* .

Lidhur me ***pikën 3, të nenit 28 të projektligjit*** rekomandojmë që në zbatimin e masave për verifikimin ose vlerësimin e moshës, të respektohen parimet e përpunimit në përputhje me qëllimin, proporcionalitetit dhe minimizimit të të dhënave personale, duke synuar që zbatimi i detyrimeve për mbrojtjen e të miturve të mos sjellë përpunim të panevojshëm ose të tepruar të të dhënave personale.

Në këtë kuptim, për të garantuar një mbrojtje sa më të plotë të të miturve, sugjerojmë që në këtë pikë të shtohet edhe fjalia me përmbajtje: "*...Çdo masë për verifikimin ose vlerësimin e moshës duhet të jetë e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin specifik dhe legjitim të ndjekur dhe të kufizohet në përpunimin e të dhënave personale të përshtatshme dhe të nevojshme për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale".*

Në nenin 38 të projektligjit, referenca e bërë në këtë dispozitë ndaj nenit 4 të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", vlerësohet se duhet të rishikohet, pasi përkufizimi i "profilizimit" në kuptim të ligjit nr. 124/2024 përcaktohet në pikën 19, të nenit 5 të këtij ligji.

Për sa më sipër, me qëllim saktësinë e referencës ligjore si dhe traspozimin e saktë me nenin 38 të DSA-së, sugjerohet që në ***nenin 38 të projektligjit*** togfjalëshi " … *sipas nenit 4 të Ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale*" të zëvendësohet me

togfjalëshin " *...sipas pikës 19, të nenit 5, të ligjit nr. 124/2024 'Për mbrojtjen e të dhënave personale'*."

Në vijim, në ***nenin 33 të projektligjit***, vërehet përdorimi i shkurtesës "VLOPSE", pa u përcaktuar shprehimisht në dispozitat e projektligjit kuptimi i saj. Edhe pse kjo shkurtesë në Relacion shpjegohet dhe i referohet kategorisë së "*Very Large Online Platforms and Very Large Online Search Engines*", përkatësisht platformave online shumë të mëdha dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit online, sugjerojmë që në përdorimin e parë të termit në projektligj të jepet përcaktimi i plotë i kësaj shkurtese, me qëllim garantimin e qartësisë dhe kuptueshmërisë së dispozitave përkatëse.

Sa i përket ***nenit 49 të projektligjit***, vlerësohet e nevojshme të rishikohet dhe të qartësohet kuadri i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale dhe autoriteteve të tjera kompetente, me qëllim përcaktimin dhe ruajtjen e kompetencave dhe përgjegjësive të përcaktuara me ligj për secilin autoritet, si dhe përcaktimin e mekanizmave për trajtimin e çështjeve që përfshihen në fushën e kompetencës së më shumë se një autoriteti.

Projektligji identifikon Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoritet kompetent në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por nuk qartëson më tej se cilat aspekte të zbatimit të proejktligit bien në kompetencën e tij dhe si ndërthuren ato me kompetencat e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale. Në veçanti, nuk rezulton e qartë në cilat raste Komisioneri ushtron kompetencat në mënyrë të pavarur, në cilat raste vepron në bashkëpunim me Koordinatorin dhe si koordinohet ushtrimi i kompetencave në rastet që prekin njëkohësisht zbatimin e projektligjit për shërbimet digjitale dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Veçanërisht problematike konsiderohet pika 4 e nenit 49, sipas të cilës dispozitat e zbatueshme për kompetencat e Koordinatorit për Shërbimeve Digjitale, të përcaktuara në nenin 51, zbatohen për çdo autoritet tjetër kompetent të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, ku përfshihet Komisioneri. Bazuar, në parimin e sigurisë juridike dhe qartësisë së normës, përcaktimi i qartë dhe i saktë i kompetencave merr një rëndësi të veçantë jo vetëm për shkak të shmangies së konfliktit të kompetencave që mund të lindë midis institucioneve, por mbi të gjitha për vetë subjektet të cilëve i drejtohet ligji, në mënyrë që këta të fundit të jenë të qartë se cili është organi që vendos për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe marrëdhënien që duhet të krijojë ai me këto institucione. Prandaj, projektligji duhet të parashikojë një ndarje më të qartë të kompetencave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe projektligjin, qoftë edhe në mënyrë jo shumë të detajuar, për t'ia lënë më pas vendin marrëveshjeve ndërinstitucionale që përmes autorizimit ligjor të përcaktojnë saktë se kush bën çfarë dhe në cilat kushte apo raste.

Përveç sa më lartë, përcaktimi i qartë dhe i saktë i kompetencave është akoma më i rëndësishëm kur merret parasysh fakti se në datën e aderimit të Republikë së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, DSA do të jetë drejtpërdrejtë e zbatueshme dhe janë pikërisht këto çështje që i lihen si detyrim Shteteve Anëtare për të rregulluar në legjislacionin e brendshëm. Këtu, sjellim në vëmendje që paragrafi i tretë i pikës 2 të nenit 49 të DSA

parashikon shprehimisht se "*..kur një Shtet Anëtar cakton një ose më shumë autoritete kompetente përveç Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale, ai duhet të sigurojë që detyrat përkatëse të këtyre autoriteteve dhe të Koordinatorit të Shërbimeve Dixhitale të jenë të përcaktuara qartë dhe që ato të bashkëpunojnë ngushtë dhe në mënyrë efektive gjatë kryerjes së detyrave të tyre*".

Ndërkohë në raport me ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" të ndryshuar vlerësojmë të mbahen në vëmendje sugjerimet si më poshtë vijon:

Ndërkohë, lidhur ***me nenin 56 të projektligjit*** dhe siç dhe shpjegohet dhe në Relacionin e tij, ky nen përcakton detyrimin e sekretit profesional për të gjithë autoritet e përfshira, në zbatimin e tij sa i përket informacionit që shkëmbejnë dhe përdorin. Vërejmë se ndalimi është i një karakteri absolut përmes togfjalëshit "*...nuk do të publikojnë informacionin e marrë, ose të shkëmbyer prej tyre, në përputhje me këtë ligj si dhe të çdo informacioni, që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional."*

Në këtë drejtim sugjerojmë që ky togfjalësh duhet të rishikohet sepse nuk është në përputhje me parashikimet e Konventës së Këshillit të Evropës "*Për aksesin në dokumente zyrtare*", të ratifikuar me ligjin nr. 45/2022 (*e cila ka epërsi ndaj ligjit që synohet të miratohet), si dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" të ndryshuar (si ligji i zbatueshëm në rastet e kërkesave për informacion*), të cilët nuk parashikojnë asnjë ndalim absolut mbi çdo informacion, siç parashikohet nga ky nen projektligjit.

Përdorimi i lidhëzës "*si dhe*" në këtë togfjalësh, nënkupton që jo vetëm çdo informacion, që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional nuk duhet të publikohet, por nuk duhet të publikohet as çdo informacion tjetër i marrë ose i shkëmbyer në zbatim të këtij ligji.

Gjithashtu, duke mos e përjashtuar mundësinë që mospërputhja të jetë krijuar edhe thjesht si pasojë e një gabimi si rrjedhojë e përkthimit të tekstit , vlerësojmë që togfjalëshi "*..si dhe të çdo informacioni, që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional*" nuk është në përputhje edhe me vetë nenin 84 të DSA. Ky nen parashikon togfjalëshin "*shall not disclose information acquired or exchanged by them pursuant to this Regulation and of the kind covered by the obligation of professional secrecy*", i cili në shqip do të përkthehej "*...nuk do të zbulojnë informacionin e marrë ose të shkëmbyer prej tyre në përputhje me këtë Rregullore dhe të llojit të mbuluar nga detyrimi i sekretit profesional"*.

Në këtë kuptim, për shkak të përdorimit të lidhëzës "*dhe*", që informacioni të mos publikohet duhet që ai të plotësojë dy kushte kumulative:

a) ai të jetë marrë ose shkëmbyer në zbatimi të këtij ligji;
b) dhe të jetë i atij lloji që mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional.

Ky është i vetmi interpretim literal dhe sistematik që mund t'i jepet kësaj dispozite dhe siguron edhe zbatimin e saj në harmoni me Rregulloren (KE) nr. 1049/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 30 majit 2001 mbi qasjen e publikut në dokumentet e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit.

Një interpretim *a contrario*, do të sillte si pasojë që DSA të mos lejonte publikimin e asnjë informacioni të marrë apo shkëmbyer në zbatim të saj dhe do ta bënte edhe Rregulloren nr. 1049/2001 të pazbatueshme në këtë fushë, çka është papajtueshme me përmbajtjen e kësaj të fundit.

Sa më sipër, në mënyrë që ky nen, jo vetëm të jetë i përafruar në mënyrë të plotë me DSA, por edhe të jetë në përputhje edhe me legjislacionin e brendshëm në fuqi për të drejtën e informimit, sugjerojmë që në ***nenin 56 i projektligjit,*** togfjalëshi i sipërcituar të ndryshohet me këtë përmbajtje: "*... nuk do të zbulojnë informacionin e marrë, ose të shkëmbyer prej tyre në përputhje me këtë ligj dhe që përbën informacion që mbulohet nga detyrimi i sekretit profesional.*"

Së fundmi, duke qenë se projektligji e përfshin Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ndër autoritetet kompetente për zbatimin e ligjit, në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, nga shqyrtimi i relacionit shoqërues nuk rezulton të jetë kryer një analizë e ndikimit institucional dhe financiar mbi autoritetet kompetente, përfshirë Komisionerin, në lidhje me burimet njerëzore dhe kapacitetet organizative të nevojshme për pjesëmarrjen e tij në mekanizmat e bashkëpunimit dhe koordinimit të parashikuara nga projektligji.

Në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian, si Franca apo Gjermania, autoritetet për mbrojtjen e të dhënave personale bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme me Digital Services Coordinator në trajtimin e çështjeve me kompetenca të ndërthurura, çka kërkon angazhim të vazhdueshëm institucional dhe organizativ. Në këtë kuadër, mund të vlerësohet nevoja për një analizë të ndikimit të projektligjit mbi kapacitetet institucionale të autoriteteve kompetente, si dhe, nëse është e nevojshme, për vlerësimin e nevojave organizative dhe të burimeve njerëzore që do të mundësonin përmbushjen efektive të këtij roli.

Në këtë drejtim, sugjerohet që rregullat dhe procedurat për bashkëpunimin ndërinstitucional, përfshirë konsultimin, shkëmbimin e informacionit, koordinimin e veprimeve dhe funksionimin e grupeve të punës, mund të përcaktohen apo konkretizohen më tej me akt nënligjor ose instrument të përshtatshëm ndërinstitucional, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi